



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
TË MBAJTUR MË 28.02.2017**

**SA JAVNE RASPRAVE KOMISIJE ZA ZAKONODAVSTVO...
0DRZANE 28.02.2017. GODINE**

**SHKURT-FEBRUAR
2017**

Mbledhjen e kryesoi nënkryetarja e Komisionit për Legjislacion, z. Selvije Halimi

KRYESUESJA: Të nderuar anëtarë të Komisionit për Legjislacion,
Të nderuar deputetë të tjerë që jeni prezentë jashtë Komisionit,
Të nderuar përfaqësues të ftuar në dëgjimin publik për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të ekzekutimit të sanksioneve penale,
Të nderuar përfaqësues të organizatave jo qeveritare vendore e ndërkombëtare,
Ne si Komision i Legjislacionit kemi shqyrtuar projektligjin, projektligji ka kalua në parim në Kuvendin e Kosovës dhe menjëherë si Komision kemi formuar grupin punues i cili do ta shqyrtoj Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Po atë ditë që është formuar grupi punues, grupi punues ka marrë për obligim që të organizoj edhe një dëgjim publik për këtë projektligj.

Udhëheqësi i grupit punues është zoti Armend Zemaj, anëtarë të tjerë të këtij grupi është, zoti Agim Aliu, Danush Ademaj, i cili lajmëroj se nuk do të jetë.

Kryetarja e Komisionit që është në pushim të lindjes ka lajmëruar dhe ka kërkuar që ta fusim në këtë grup punues dhe ka lajmëruar që do të jetë pjesë e grupit punues, besoj që do të vijë sot është e informuar që mbahet dëgjimi publik.

Kështu që për më tej puna ime proceduralisht është vetëm me hapë diskutim ose mbledhjen edhe me ju falënderua për prezencën dhe tashmë punë do të vazhdoj kryetari i grupit punues zoti Armend Zemaj.

Zoti Zemaj, fjala për ju!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!
Faleminderit të gjithëve që ju keni përgjigj sot ftesës së Komisionit.

Grupi punues ka paraparë që të mbajmë dëgjim publik, kemi konsiderua që jo vetëm si pjesë e mandatit edhe transparencës por duke marrë parasysh që edhe rëndësinë e vetë këtij projektligji.

Tash më lejoni t'i them veç 2-3 fjalë të kronologjisë historike që ne kemi paraparë si Komision.

Pikë së pari më duhet të shprehë opinionin që është edhe i grupit punues por edhe që është i Komisionit, plotësim ndryshimi i ligjit nuk përkon edhe me atë që ne kemi pasur gjatë punës tonë si Komision, sepse Komisioni për Legjislacion ka bërë monitorimin e këtij ligji në vitin e kaluar tash nëse nuk gabojmë, tash nuk e di a kemi hyrë në vitin e dytë të monitorimit të zbatueshmërisë së këtij ligji.

Kemi vizituar edhe institucionet korrektuese, kemi marrë edhe sugjerimet, vërejtjet për ligjin në fjalë por edhe për ankesat që kanë ardhur nga të dy palët, qoftë nga ata që janë të obliguar ta zbatojnë ligjin por qoftë edhe nga ata që i nënshtrohen ligjit.

Tash janë 2-3 elemente që këto janë pjesë e këtij ndryshimi, por sido që të jetë kështu e ka pa sponzorizuesi.

Faktikisht nuk është ligj i ri ky është ligj plotësim ndryshim domethënë që ka ardhur në kuadër të kësaj tash edhe pak ne jemi të kushtëzuar që t'i imponojmë ato vërejtjet edhe sugjerimet tona që kanë ardhur sepse edhe rregullat edhe procedurat e thonë kushtimishtë këtë.

Fjala ka të bëjë me pjesën që ne e kemi monitoruar sidomos te të drejtat e të burgosurve por edhe te të drejtat e stafit të shërbimit korrektues.

Në fund të këtij viti ne e kemi ftuar edhe Sindiktën e Shërbimit Korrektues të republikës së Kosovës, këtu e kemi edhe kryetarin e sindikatës sot, sigurisht që do ta paraqes fjalën e tij.

Më vjen keq që gjatë kësaj periudhe draftimit të ligjit edhe atë çka e kemi pa në ligj kërkesat e tyre nuk janë shqyrtua në këtë fazë dhe për hir të transparencës unë tash po e theksoj nuk e di pse, ne do ta debatojmë këtë edhe në të ardhmen e afërm por kjo është gjendja ku jemi.

E dyta, është një kërkesë që të shpejtohet pak procedura e këtij projektligji edhe ashtu nuk kemi çka të ndalemi në procedura të gjata sepse janë vetëm disa amendamente që kanë ardhur plotësim ndryshim i kemi këtu edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

Janë dy çështje që janë pjesë e ndryshimit që janë thelbësore janë substanciale që janë paneli për lirim me kusht domethënë organizimi i ri edhe çështja ka të bëjë me shërbimin mjekësorë një çështje e cila ka qenë diskutabile është përdorë apo është keqpërdorë nga kushto qoftë që ka dashtë ta shfrytëzojë edhe në atë spektin politik,

mbi të gjitha edhe në raportet e progresit një diçka e cila është theksua gjithmonë si vërejtje substanciale.

Kështu që ne jemi në këtë fazë, sinjerisht unë e kam thënë edhe në seancë plenare, nuk jam i kënaqur, tash ne do t'i dëgjojmë edhe përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë edhe arsyen pse nuk ka ardhur ligji i ri por është ardhur vetëm plotësim ndryshim dhe pse nuk janë përfill të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga Kuvendi të cilat janë miratua në njërin nga seancat e vitit të kaluar nëse nuk gaboj tash me datë nuk e di saktësisht.

Këto janë pyetjet tona, ne nesër do ta kem edhe grupin punues edhe ligji sipas asaj që jemi dakordua do të jetë të enjten në seancë plenare por do të vazhdojmë me punua. Në fazën tjetër edhe si Komision tash kemi bisedua edhe me kolegë në fazën tjetër do të kërkojmë nga ministria e Drejtësisë. Ne i dimë këto norma që po kërkojnë tash për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, raportin e progresit e të tjerë, por do të kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë që në një afat sa më shkurtë ta hartoj ligjin e ri komplet me i korrporua edhe këto normat, nëse kalon kjo eventualisht sepse nuk po dua me paragjykua, nëse jo atëherë ne duhet të shohim se si do të procedojmë më tutje.

Kështu që unë nuk do të shtoja diçka tash kush e donë fjalën le të paraqitet me radhë. Ju kisha lut që mos me dal shumë jashtë teme edhe mos me zgjatë shumë veç në kuadër tash që e kemi për projektligjin. Urdhëro!

ARDIAN BAJRAKTARI : Faleminderit, zoti Zemaj!

Të nderuar deputetë të Komisionit për Legjislacion,

Të nderuar deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar të pranishëm,

Në kronologji fillimisht duhet të themi se Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale ligji aktual që është në fuqi ka filluar së zbatuari në vitin 2013 dhe siç e cekët edhe ju i nderuar deputet janë disa ndryshime që konsiderohen si mjaftë të rëndësishme për arsyet para së gjithash harmonizimit të këtyre çështjeve me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sipas parimit të ndarjes së pushteteve për faktin se disa nga çështjet të cilat kanë qenë të përcaktuara me këtë ligj e që do të duhej të ishin para së gjithash çështje ekskluzive të gjykatës ju kanë bartur institucioneve tjera qoftë ministrit të Drejtësisë apo edhe organeve të tjera siç është paneli për lirim me kusht e të tjera.

Dhe mbi bazën e kësaj ne kemi pranuar dhe jemi dëshmitarë të një varg raportesh që e vë në pah këtë çështje që duhet adresua dhe mbi këtë bazë Ministria e

Drejtësisë në konsultim me organet që merren me zbatimin e këtij ligji shërbimin korrektues dhe shërbimin sprovues por edhe me partnerët ndërkombëtarë ka përgatitur këtë draft në kuadër të cilës parashihen disa ndryshime substanciale siç është:

Çështja e pezullimit të ekzekutimit të dënimit, deri më tash sipas nenit 94të Ligjit në fuqi kjo çështje ka qenë kompetencë e ministrit të Drejtësisë, me këto ndryshime kjo kompetencë i është bartur gjykatës për faktin se konsiderohet që gjykata është kompetente edhe për shqiptimin e dënimit por edhe në rrethana të caktuara për pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

Për më tepër se kaq është përcaktuar edhe rrethana se kur mund të pezullohet ekzekutimi i dënimit për trajtim shëndetësorë qoftë brenda apo jashtë vendit.

Po ashtu është paraparë edhe rishikimi i dispozitave që kanë të bëjnë për panelin për lirim me kusht duke përcaktuar edhe çështjen e të drejtës në ankesë të palëve të cilat eventualisht ju refuzohet çështja e lirit me kusht por mbi të gjitha edhe përbërja e panelit është rishikuar dhe është përcaktuar që të ketë gjyqtarë në kuadër të këtij paneli dhe atë gjyqtarë të tria niveleve që nga niveli themelorë, gjykatës së apelit dhe gjykatës supreme.

Po ashtu është përcaktuar edhe roli më aktiv i gjykatës edhe në relacion me monitorimin ekzekutimit sa i përket pezullimit të ekzekutimit si dhe është përcaktuar që edhe çështja e trajtimit shëndetësorë të të burgosurëve të jetë në nivelin për aq sa është e mundur adekuat me trajtimin e personave që ofrohet trajtim jashtë institucioneve korrektuese.

Janë këto ndryshime të cilat i kemi konsiderua që janë të domosdoshme të bëhen në një fazë të përsheptuar.

Ndërsa do të keni parasysh se çështjet që i ngritët nga ju dhe që kanë qenë edhe objekt i raportit Ministria e Drejtësisë ka filluar vitin e kaluar me fazën e rishikimit të tërësishëm të këtij sektori, është me përgatitje të strategjisë në të cilën do të përcaktohen edhe hapa konkret dhe duhet të besojmë që kjo çështje dhe ndonjë çështje tjetër eventuale që do të mund të lindë qoftë nga diskutimet që do të rrjedhin si rezultat i këtij projektligji apo edhe faza të mëvonshme ato do të mund të inkorporohen në kuadër të ndryshimeve të mëvonshme.

Është ky dëgjim dhe po mendoj që edhe nesër siç është paraparë do të përpiqemi me dhënë kontribut, të përpiqemi të arsyetojmë atë çka kemi shkruar këtu dhe

eventualisht në një çështje që e kemi diskutua bashkërisht me ministrinë veçmas çështjen e institucioneve ekonomike që funksionojnë në kuadër të shërbimit korrektues kanë pasur disa telashe dhe e kemi propozua një amendament besoj që do ta diskutojmë nesër në kuadër të grupit punues. Faleminderit!

ARMED ZEMAJ: Faleminderit, Ardian!

Dikush tjetër, urdhëro, veç prezantohu për hir të kolegëve këtu.

ALBAN MURIQI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë,

Jam Alban Muriqi, nga Qendra Kosovare për Rabilitimin e të Turturës.një organizatë që monitoron qendrat korrektuese nga viti 2007 në mënyrë të rregullt.

Kemi bashkëpunim shumë të mirë me Ministrinë por edhe me shërbimin korrektues dhe në këtë kuptim kemi pasur një bashkëpunim edhe gjatë procesit të hartimit të strategjisë të cilin e përmendi kolegu parafolës.

Ne kemi menduar që disa ndryshime që reflekton strategjia për ekzekutimin e sanksioneve penale është momenti i duhur që të përfshihet tani në këtë projektligj. Mirëpo me qenë se plani qenka për më vonë në rregull jemi prapë domethënë.

Unë i kam lexua domethënë këto ndryshime të projektligjit janë ndryshime shumë sipërfaqësore, janë ndryshime shumë të vogla ndoshta edhe nuk ja ka vlejtur meqë nuk ka ndonjë çështje shumë specifike për mu adresua kështu në mënyrë urgjente, ndoshta nuk ja ka vlejtur edhe që të përfshihen në këtë fazë ose tani për tani.

Ne kemi disa vërejtje te pezullimi i dënimit si dhe te trajtimi i jashtëm mjekësor, të gjitha ndryshimet po thuaj se i reflekton ose janë rreth këtyre dy aspekteve.

Ndërse ne presim edhe kemi përkrah panelin për lirim me kusht, ndryshimet në strukturë dhe në gjithë procesin e vendosjes pasi ka pasur shumë probleme gjatë viteve në punën e këtij paneli, po ashtu lirimi i parakohshëm dhe themelimin e njësisë ekonomike janë disa aspekte që i kemi mirëprit dhe i mbështesim. Kur jemi te pezullimi i vendim kërkoj falje nëse ju marr pak kohë vetëm është neni 43/b, ekzaminimi i specializuar mandej të qojnë te pezullimi. Thuhet se me kërkesë të personit të dënuar drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë kontroll mjekësor specialistik edhe nëse mjeku i institucionit nuk ka urdhëruar një kontroll të tillë.

Ne mendojmë se kjo përbën një konflikt interesi dhe nuk është roli i drejtorit domethënë të urdhërojë kontrolle ose ekzaminime të jashtme mjekësore, madje edhe në rastet kur mjeku nuk ka dhënë një urdhër të tillë, kjo është në kundërshtim me pavarësinë profesionale dhe përgjegjësinë profesionale të mjekut dhe është një trend ose një parim i mirënjohur ndërkombëtarisht dhe mendoj se kjo në këtë kuptim duhet të ndryshohet. Mjeku është ai i cili e bart përgjegjësinë profesionale për një urdhër të tillë edhe mendojmë se kjo duhet të ndryshohet. Mandej, kemi edhe çështjen e pezullimit ku thuhet se aktvendimi për pezullim të përkohshëm të ekzekutimit të dënimit me burgim për arsye të përmendura më lartë bazohet në vlerësimin mjekësor të një komisioni i cili përbëhet nga tre anëtarë, domethënë tre mjekë, përgjegjësinë për këtë vendim e merr kryetari i gjykatës kompetente, ndërsa vetë kryetari i gjykatës kompetente e themelon ose e emëron këtë komision.

Është një konflikt i pastër interesi derisa ai vetë vendos për pezullim dhe vetë e cakton komisionin i cili e rekomandon këtë, domethënë është një konflikt në vetvete i interesit. Mendoj se edhe kjo në këtë kuptim duhet të ndryshohet për të shmangur ndonjë ndikim apo influencë çfarëdo qoftë në punën e këtij komisioni. Ky komision duhet të jetë i pavarur dhe nuk duhet të ketë ndërveprim të drejtpërdrejtë me kryetarin e gjykatës kompetente i cili vendos për pezullim. Faleminderit shumë për vëmendjen tuja!

Do t'i dërgojmë edhe me shkrim këto dhe do t'i arsyetojmë.

ARMEND ZEMAJ: Po, faleminderit insisto i edhe kolgu domethënë nëse keni propozim me shkrim që referohet nenit bazë nesër ose ju kisha lut që sot ta dërgoni në sekretari të Visari, edhe besoj që edhe ne do ta shqyrtojmë nëse e shohim të arsyeshme. Urdhëro, dikush tjetër? të ka mbet ty sindikata.

ZENUN SADIKAJ: Unë quhem Zenun Sadikaj, kryetar i Sindikatës së Shërbimit Korrektues. Më vjen mirë që këtu pat diskutime për të burgosurit se edhe ne mundemi me qenë pjesë e tyre, mirë është edhe atyre që të ju bëhen standardet, po kurrë tjetër bile në komunikacion me pas fare delikti

Mirëpo, për ne stafin të Shërbimit Korrektues shumë pak edhe në Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale shumë pak shkruan për ne. E drejta dhe detyrimet që dalin njëherë si punëtorë të shërbimit korrektues. U fol për shëndetësinë e të burgosurve, shumë në rregull është çdo njeri është për ta trajtuar ashtu si duhet, qysh e meriton një njeri, mirëpo aty shkruan në ligj se për stafin tonë çdo dy vjet bile duhet të jetë së paku një kontroll. Unë po ju garantoj që 16

vjet e gjysmë punoj asnjë kontroll shëndetësorë nuk është bërë për stafin, këtë lirisht mund ta cekim.

Domethënë, përpos një injeksion para 7-8 viteve na kanë dhënë nga një injeksion, domethënë asnjë kontroll shëndetësorë. Me letra çdo gjë në rregull, mirëpo praktika tregon shumë ndryshe. Unë jam një lloj transportuesi i kërkesave të stafit, ne si sindikatë kemi kërkuar edhe që kemi pas një punëtori e kemi pas atje, dhe me ju që kemi pas zoti deputetë për legjislacion që jeni, që Shërbimi Korrektues kërkon të ketë ligj në vete, përderisa Policia ka, doganat e kanë, e kanë edhe shumë të tjerë për shembull që janë pjesë e uniformës, ne nuk kemi ligj. Nuk e di ministria jonë kush ja ka mllatis në kry këtyre që ne me një udhëzim administrativ trajtohem, domethënë jemi diku afër 1700 punëtorë që punojmë në burgje dhe me një udhëzim administrativ që ashtu qysh ju teket na gjuajnë, nëse ju bie mirë ministrisë tonë thonë jeni me Ligj të shërbimit civil ka raste, nëse s'ju bie diçka thotë me Ligj të punës.

Ligji i punës është bazë i çdo ligji, sipas qysh e di unë, mirëpo ne enkas ligj për zyrtarë korrektues nuk kemi dhe shumë kemi problem sidomos rreth pushimeve mjekësore, pushimit të lehonisë, shumë probleme se ashtu qysh ju teket na gjuajnë, domethënë ne sado i dobët që të jetë ligji më mirë e din që është ligj se sa kush të teket vjen dikush ministër edhe tash na gjuan si topin herë në të majtë e herë në të djathtë, edhe si kërkesë e sindikatës, jo tash po ish ministri zoti Hajredin Kuçi që ju bë kërkesat që janë të evidentume kërkesat që çdoherë kemi lyp të jetë një ligj i veçantë për Shërbimin Korrektues. Nuk po e di a ka qenë këtu po po më duket që është momenti ta them se mua këta nuk po më dhënë as hapësirë në fakt ministria jonë që të ju them. Unë kam kërkuar dy herë takim me ministren, s'më ka pranuar shumë është e zënë, e di që është shumë e zënë, më ka dhënë urdhëro fol me dy zëvendëset. Dy takime i kam me zëvendësit kam fol, kurrëgjë tjetër. ju e dini zoti Zemaj ju e dini që më është dashur të kërkoj ndihmë edhe prej juve si Komision Legjislacion për të bërë diçka.

Domethënë, ministria jonë shumë pak mos të them fare, po shumë shumë pak ka bërë për staf është fjala rreth ligjeve këtu. Ka shumë mirëpo unë në pika të shkurta këto kish kërkuar ndihmë tek e fundit nga ana juaj të na ndihmoni, se nuk po dihet jo pensionimi jo këto. kemi njerëz kam folur edhe atë ditë, me të vërtetë kemi njerëz të sakatuar në moshë 62 vjet i ka ai, mirëpo e mban familjen me at pagë, vjen me shtagë kroqe me uniformë vjen në punë, rreth sigurimit shëndetësor ishalla bëhet diçka tani ndoshta aty rregullohen do sene se për ne edhe policia jemi plakë, unë po ju them që jemi plakë me mosha që diku rreth 8 vite s'është pranuar

kurkush në shërbim korrektues është fjala për Dubravë, domethënë nëse i ka pas 20 vjet sot i ka 28, plus ne të tjerët mos të vesim, më i riu duhet me qenë 28 vjet. Faleminderit për dëgjim!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, i nderuar!

Unë e potencova edhe në fjalën hyrëse time, sepse kjo pjesa mungon në plotësim ndryshim të këtij ligji. Ajo çka dëgjuam edhe nga përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë që në kuadër të strategjisë sigurisht do të bëhet edhe një plan i saktë të trajtimit tuaj në të gjitha fazat që edhe ju i potencuat me të drejtë besoj, sepse ne i kemi shqyrtuar, i kemi analizuar shumë qartë edhe kemi ardhur në përfundim se një shërbim korrektues i fortë duhet me qenë që të ketë edhe sundim të rendit, sundim të ligjit sa i përket asaj pjese pavarësisht pjesë tjetër.

Kështu që edhe sot po ju them bisedat që i kemi pasur edhe si komision kështu edhe zyrtarisht, por edhe jo formalisht ne do të merremi prapë me këtë çështje pavarësisht tash plotësim ndryshimit të këtij ligji, po do të shohim në fazën shumë më të shkurtë kohore se si do të trajtohet qoftë edhe me ligje tjera, sepse është edhe Ligji për pagat që është prit që të vijë në Kuvend do të shohim kategorizimin edhe seleksionimin ku ju do të selektoheni, por edhe kjo pjesa tjetër sepse është problem i përgjithshëm kjo sigurimet shëndetësore nuk po dua tash që të bëj krahasime, por është mungesë e përgjithshme institucionale që nuk i përket vetëm institucionit të juaj. Ato çka janë gjet në kohën e UNMIK-ut i kanë trashëguar edhe janë duke përfutur prej tyre, por shumica e sidomos ju dhe policia besoj që duhet të kenë trajtim të veçantë. Nuk kemi informata të sakta se deri ku ka mbërri ky proces.

Ajo çka na theksohet është që janë duke u trajtuar seriozisht, por ne do ta shqyrtojmë edhe këtë seriozitet. Tash unë po ia kaloj fjalën te kolegët deputetë në qoftë se ka dikush diçka. Naitin po e shoh këtu edhe pse nuk është anëtarë i komisionit, besoj që ka diçka të thotë, nëse s'kanë kolegët e mi urdhëroni.

Jo ne jemi për të ju dëgjuar sot, ju dëgjojmë kush është ardh mysafir.

NAIT HASANI: Faleminderit!

Përsëritet edhe përfaqësuesit kolegë deputetë,

Për mua është një projektligj mjaft i rëndësishëm që zgjidh shumë çështje në procedurën penale, të sanksioneve, por ajo që unë kam ardhur është përveç vërejtjeve tjera që përmendën zyrtarët është dhe një pjesë që unë po kërkoj ta shtojnë në projektligj. Ky është plotësim ndryshim që mund të hyjë, një amendament e kam bërë e kam proceduar në arkivë atje që të ju vijë juve komisionit, ndoshta ju ka ardhur ndoshta s'ju ka ardhur ende.

Po, sigurisht që vjen është, më 15.2.2017, e kam protokolluar në muajin që ka kaluar në Kuvend. Në bazë të drejtave kushtetuese që na jep neve Rregullorja e punës së Kuvendit unë kam propozuar një amendament që në pjesën e ligjit bazë nenit 17, për ekzekutimin e sanksioneve penale pas paragrafit të dytë të shtohet një paragraf i ri, si në vijim: që qëllimi i burgjeve nuk është shkatërrimi i njerëzve, por është rikthimi në jetë, përmirësimi i tyre, mundësia e një lehtësie më të mirë, nëse ne duhet t'i lëmë nëpër burgje, do t'i shkatërrojmë nuk i bëjmë të aftë ne për familjet e tyre pasi që t'i kryejnë sanksionet. Nëse duam t'i kthejmë ata në jetë, t'i bëjmë të aftë për familjet e tyre pavarësisht për gabimeve që kanë mund t'ju ndodhin në rrethana të caktuara, e përmendi tha që në aksident mund t'i ndodh, a duhet ta shkatërrosh atë që e ka bërë një aksident ose çfarëdo rasti tjetër.

Prandaj, duhet t'i kthesh njerëzit në jetë, për t'i kthyer njerëzit në jetë duhet edhe mundësia e lehtësirave edhe ato që patën lirimet me kusht, lirimet që i përmendi që është një konflikt i interesi në raport me mjekun dhe kryetarin e gjykatës, i njëjti t'i zgjedh, i njëjti t'i vendosë, por edhe tjetra që çështjet e shërbyesit civil a po janë shërbyes profesional. Unë e di që korrektuesit, më ka ra me qenë pjesë e burgjeve, ata janë profesionalë, kanë pasur trajnime profesionale, domethënë është dallon prej të gjitha shërbimeve tjera. Nëse një gardian nuk është profesional atëherë kush ka me qenë profesional që ai duhet të trajtojë të burgosurin edhe në forma të ndryshme të burgut, masat, mbrojtjen, sigurinë, sigurimin shëndetësor, pagat e po ashtu si pagat me një akt nënligjor rregullohen nga Qeveria.

... edhe një çështje por ajo që është me rëndësi këtë e kanë një pjesë të ligjit të gardianit të dytë, edhe gardianët edhe të burgosurit janë pjesë e burgut. Të dy janë të burgosur në njëfarë forme, këta janë me afat kohor tetë orë edhe dalin prej aty ose me afat 12 orë edhe dalin ndërsa i burgosuri e ka 24 orë. Do të thotë, të dy janë me stazh të beneficium, domethënë gardianët janë me stazh të beneficium ndërsa të burgosurit jo. Tash për të mbërri beneficionet ne për t'i kthyer në jetë njerëzit më mirë, për t'i bërë më të aftë për familjen, me ju tregua që burgjet nuk janë që duan të ju shkatërrojnë, por burgjet janë pjesë të sanksionit që ju e keni bërë një faj dasht ose pa dashur që t'i ktheheni jetës edhe të kthehet në familjet e juaja dhe ta vazhdoni jetën në familje.

Prandaj, amendamenti është që një ditë 24 orësh e kaluar në ekzekutimin e dënimit me burg, duhet të jetë e barasvlershme me një ditë e gjysmë ose 36 orë të kaluara në liri. Domethënë, edhe kjo është për të burgosurit për një mundësi e lehtësirave, të ju mundësojmë njerëzve që i kanë vuajt. Ai që i vuan 10 vjet burg si i mbajti 20, si edhe 30 ai e ka kryer çështjen e vetë. Nëse i ka mbajti 10 vjet edhe ti

i thuash do t'i mbash 20 vjet, ditën –ditë, ti nuk e ke kthyer më në jetë atë, ti e ke lënë të paaftë, e ke bërë barrë të familjes, barrë të shoqërisë edhe barrë të institucioneve shtetërore që duhet të kërkojnë raste sociale.

Prandaj, të paktën njerëzit duhet ta kenë një mundësi të ju jepet ajo edhe në anën tjetër është një buxhet financiar që lirohet qeveria, në anën tjetër lirohen edhe familjet, nëse tash për shembull në bazë të statistikave që i kemi janë 1800 të burgosur, nëse do të liroheshin ata 1800 të burgosur vetëm për nga një vit, 20 milionë Qeveria e Kosovës do të lirohet brenda buxhetit vjetor, ndërsa familjet do të lirohen nëse çdo vizitë e familjes është 50 euro në muajt për vizitat që i bën brenda vitit ajo lirohet diku për 1 milionë euro, a brenda muajit është 90 mijë euro domethënë lirohen familjet nga buxhetit që duhet, se duhet me shku me ju ble një keks, një duhan, një qokolladë, të gjitha ato kështu që ajo është ju që punoni atje edhe është një mundësi që të ju jepet një mundësi që të përmirësohen.

Prandaj, lirimi i familjes, lirimi i shtetit ku ka mundësi të investohet në përmirësimin e kushteve tjera, të cilat janë të nevojshme nëpër burgjet tona edhe në institucioneve, ose rregullimi i shëndetësisë ose sigurimeve shëndetësore, ose të pagave të ndryshme. Prandaj, unë po kërkoj që amendamenti im që e kam bërë edhe e kam protokolluar atje në zyrën e arkivit për juve të merret parasysh dhe ta qesim ose ta pranoni si pjesë e komisionit tuaj që të jetë pjesë e seancës ta votojmë, t'i japim një mundësi edhe të burgosurve t'i kenë këto lehtësira. Përveç atyre që i përmendëm në bazë të ekzekutimit të sanksioneve penale që është lirimi me kusht, sigurime shëndetësore e tjera e tjera. Faleminderit!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, Nait!

Urdhëro Bislim a dashte diçka? Bislim Zogaj.

BISLIM ZOGAJ: Unë nuk do të zgjas shumë, se edhe unë mendoj që qëllimi kryesor i këtij ligji po besoj se edhe çdo ligj tjetër mbi të gjitha duhet ta ketë që kur të bëhet një ligj ta ketë çështjen humane. Kështu që, mendoj se edhe ky ligj ka më së shumti nevojë që të ketë kosto të orientuar rreth çështjes humane. Besoj, se Naiti, sa i përket këtij ligji dha shumë elemente, por edhe unë pajtohem sa i përket këtij neni, që e propozon Naiti, sepse përveç tjerash e kemi përjetuar edhe vetë burgun dhe mendoj se në burg shkojnë edhe ata që bëjnë veprat me qëllim, po edhe ata që bëjnë pa qëllim. Mendoj, se ata që bëjnë vepra pa qëllim, në momentin që ka bërë veprën ai është i dënuar edhe gjyqi kur ta dënojë, domethënë dy herë po dënohet, kurse ne kemi për obligim, që të paktën, të mendojmë pak me humanizëm dhe të bëjmë diçka, në mënyrë që të ketë edhe humanizëm në këtë fatkeqësi të tyre.

Prandaj, edhe unë pajtohem dhe kërkoj që në këtë ligj të hyjë gjithsesi ky nen, që të llogaritet ashtu siç e tha edhe Naiti. Për fillim kaq, sigurisht se edhe nesër ose ditëve të tjera do të jemi në kontakt.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Dikush nga kolegët tjerë, nëse ka diçka, nëse s'ka po ua jap fjalën... Po, urdhëroni... A do Selviqe apo...

SELVIJE HALIMI: Jo, unë te drafti kam.

ALBAN MURIQI: Faleminderit! Edhe njëherë, kryesues, kërkoj falje, por desha t'i përforcoj mendimet dhe propozimet e deputetëve të nderuar edhe nga perspektiva e monitorimit që e bëjmë në çdo ditë dhe komunikimit, si dhe raportimeve tona.

Ne komunikojmë shumë me të dënuarit, të paraburgosurit, familjarët e tyre, mirëpo i përcjellim edhe trendët, bëjmë edhe shumë hulumtime. Ne shohim se motivet për risocializim, rehabilitim, ose kthim në jetë në mënyrë normale, ose të rregullt, si pjesëtar i vyeshëm i shoqërisë, siç përdoret, janë të vogla në institucionet tona korrektuese. Dënimet, ose politika ndëshkimore, është ashpërsuar shumë në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin Penal, që janë miratuar para tri vjetësh. Strategjia i adreson shumë këto probleme, strategjia për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ne nuk kemi një përvojë shumë të mirë me këto strategji, me këto dokumente politike, që janë më shumë për shkak se ka munguar zbatimi i tyre i duhur, mirëpo kjo me të vërtetë është një strategji që afirmon shumë humanizimin e sanksioneve penale.

Kur jemi në perspektivën e monitorimit, ne shohim se për shembull, procesi i faljes nuk ka shkuar shumë mirë dy tri vjetët e fundit, nuk kanë përfituar nga falja, nga amnistia vetëm pjesërisht. Domethënë, gjysmëliria si sanksion alternativ, prej se është aplikuar, parashihet vetëm në një rast të vetëm, prej tri vjetësh që e parashihet kodi, domethënë vetëm një rast e kemi. Sanksionet penale, ose dënimet alternative pak aplikohen. Për vëmendjen tuaj është me rëndësi një statistikë interesante, ne kemi bërë një hulumtim para tre vjetësh. Në mesin e shtatëmbëdhjetë vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, Kosova është e dyta për shpenzime për kokë banori në ditë, diku me 27 ose 28 euro, vetëm republika Çeke harxhon më shumë, të gjitha të tjerat janë më pak. Normal, ne jemi për të shpenzuar dhe për t'u ofruar kushte të mira, mirëpo për 28 euro nuk ofrohet shumë në shërbimet korrektuese, në kuptimin e infrastrukturës. I mbajmë relativisht mirë, por u mungojnë programet e rehabilitimit, risocializimit dhe, njerëzit e kalojnë kohën atje kot, pa kurrfarë aktiviteti, pa kurrfarë terapie, pa kurrfarë angazhimi dhe kjo i bën ata të demotivohen dhe të bien në depresion.

Kemi probleme të shumta me të dënuar me probleme mendore, ndërsa shërbimet e shëndetit mendor nuk janë në nivelin shumë të mirë.

Domethënë, ne mendojmë se propozimi për llogaritjen e dënimit në vite të ulëta, sikurse është një trend ndërkombëtar dhe evropian dhe kjo është një motiv shtesë i tyre edhe kjo. E kemi mirëpritur shumë panelin për lirim me kusht dhe ristrukturimin e tij, pasi ka qenë i vetmi motiv i tyre. Ata, domethënë kanë përfituar shumë pak nga lirimi me kusht. Kemi pasur shumë raste, kolegu e din, po edhe nga falja, pra kolegu nga sindikata e din, kur të dënuarit atje kanë përfituar nga beneficionet e regjimit të hapur, nga puna, vikendet, e të tjera... ndërsa, paneli i ka refuzuar 6-7 herë. Domethënë, ka qenë në kundërshtim me vetë vlerësimin atje. Edhe sot, domethënë tash me këto propozime, është një avancim i kësaj pozite.

Vetëm desha ta përforcoj dhe kërkoj falje prapë. Faleminderit!

SELVIJE HALIMI: Unë parëz desha ta ngre një shqetësim te neni 17, që e ka propozuar ministria, te neni 18, ku parasheh në nenin 22 të riformulohet paragrafi 2, është në rregull riformulimi dhe në nenin 122 pas paragrafit 3, 4, shtohet një paragraf i ri, ku lejohet ankimimi i panelit dhe nuk ceket se kujt duhet t'i adresohet ankimimi, në rast se i dënuari dëshiron të ankohet në vendimin e panelit. Dhe, në ligjin bazë nuk thuhet se duhet të fshihet neni pasues, po mendoj paragrafi pasues, që e ndalon, faktikisht dobia në këtë rast e këtij plotësim-ndryshimi është se e lejon ankimimin, por nuk na jep që paragrafi 5 duhet të hiqet nga ligji bazë, sepse kemi pastaj një dualizëm, njëri nen e lejon, tjetri e ndalon.

Do të thotë, duhet te propozimi i draft-ligjit, te neni 18, te paragrafi 5, ose te neni 122, që thotë: “pas paragrafit 4 të shtohet paragraf i ri, që lejon ankimimin”, duhet të plotësohet në cilën shkallë apo cili është organi që duhet t'i drejtohet ankesa nga ana e të dënuarit, sepse ligji bazë nuk e ka këtë, sepse e ka ndaluar dhe nuk të ka dhënë të drejtë pastaj shkallë ankimimi. Kjo duhet të ekzistojë, që do të thotë se duhet ky ligj ta krijojë edhe një komisioni i cili do t'i pranojë ankesat e të dënuarve.

Ne si deputetë nuk mund ta themelojmë atë komision, por duhet ta mendoni ju si ministri dhe ta sillni, bini propozimet, nesër komisioni, grupi punues, do ta mbajë takimin ju sillni propozimet.

Te çështjet shëndetësore, që u ngritën nga kolegu Muriqi, besoj që kolegu do ta sjellë edhe propozimin, se si do të duhej të dukej ai ndryshim. Çështja e propozimit të kolegut Hasani, dua konfirmim prej ministrisë, sepse të gjitha shtetet e rajonit që

synojnë BE-në, po të gjitha shtetet edhe që janë pjesë e BE-së e kanë këtë propozim në përlllogaritjen e dënimit, kështu që është mirë që edhe ju të sillni qëndrimin e juaj, si ministri.

Interesimi ynë është që në kuadër të reformave të sistemit të drejtësisë, sepse parashihet që të gjitha ligjet t'i nënshtrohen një rishikimi. Të ndihmohen ata të cilët dënohen për vepra penale, sepse përjashtim atyre që në mënyrë të organizuar mund të veprojnë në kundërshtim me ligjin dhe e bëjnë këtë me vetëdije, të gjithë të tjerëve me momentin e kryerjes së veprës e dënojnë vetveten për shkak të moskontrollit të ndjenjave të veta apo të momentumit, dhe i ka shtyrë që të bëjnë një vepër penale.

Do të thotë, është mirë që kjo të diskutohet. Ne si komision do ta shqyrtojmë shumë seriozisht dhe në qoftë se, ne aspirojmë që të bëhemi vend anëtar i Bashkimit Evropian, duhet që edhe ligjet t'i kemi të përafërta, edhe pse e kam për bazë faktin që nuk ka ndonjë rekomandim të BE-së që të gjitha shtetet duhet ta bëjnë këtë, përlllogaritjen ta bëjnë prej këtij limiti në atë limit, sido që të jetë të gjitha shtetet kanë vepruar në këtë drejtim dhe ne do ta analizojmë mirë.

Unë nuk e di pse edhe ministria nuk e ka analizuar si duhet, kur ka pasur kërkesa dhe keni pasur mjaft kohë, që të vijë propozimi drejtpërdrejtë nga ministria. Sido që të jetë, është çështje për të cilën do të vendosin edhe vetë deputetët, por është mirë që t'i ndihmojmë të dënuarit. Pse? Po që se, ne nuk mund t'i ofrojmë një mundësi një të dënuari, që ai të punojë punë të dobishme për shoqëri, që ai të punojë dhe në njëfarë forme edhe të fitojë të hyra financiare nga puna e tij me ato përqindje të limituara, si janë të rregulluara në vendet tjera, ti rregullojua kushtet sa të duash në aspektin ushqimore, rregullojua kushtet sa të duash në aspektin e fjetjes dhe të qëndrimit brenda, ne faktikisht po krijojmë, ose po prodhojmë persona të sëmurë, sepse e dimë që për një jetë të shëndetshme, nuk e kontestoj çështjen e ushqimit, sepse e kam parë dhe besoj se ashtu është duke shkuar, sikurse gjatë vizitave, por duhet të krijohet ndjenja se ai në të njëjtën kohë vuan dënimin, për në të njëjtën kohë shteti apo shoqëria e konsideron atë të dobishëm për vetë shtetin, por edhe për vetë familjen.

Fundja, në qoftë se një bashkëshorte ka 2, 3, 4... fëmijë me një bashkëshort, i cili për shkak të veprimit të tij të paligjshëm është i dënuar dhe nuk i lejohet asnjë lehtësim, që ai pas vuajtjes së dënimit të dalë i dobishëm si bashkëshort, si baba dhe si qytetar i Kosovës, ne faktikisht kemi cenuar, në njëfarë forme, edhe të drejtën e asaj familje, që familjari i tyre pas dënimit të kthehet i vlefshëm për ta.

Ju kemi shkaktuar vuajtje psikike, por edhe vuajtje të tjera, në mungesë të personit që ata e kanë në shtëpi.

Shtrohet pyetja: Po ai person që ka bërë veprën, a nuk ka menduar se ka familje para se ta bëjë veprën? Shumica e veprave penale apo të kundërligjshme, ose mbi 90% të këtyre veprave bëhen në momente afekti, kur njeriu nuk mund ta kontrollojë vetveten. Po, shto kësaj jetën e kaluar që kemi pasur ne si shoqëri, tranzicionin me të cilin jemi duke u përballur, periudhën e luftës, periudhën e okupimit, secili nga ne që jemi në liri na vjen një sekondë kur mund të mos e menaxhojmë vetveten, por ja që ende jemi duke e menaxhuar.

Por, çka me ata të cilët në njëfarë forme apo një tjetër, nuk kanë qenë të përgatitur për momente të rënda që mund t'u vijnë para vetes dhe ta stopojnë veten nga ai veprimi i asaj sekondës në ndërdijen e tij që të shkaktojë veprën penale.

Është e dhembshme, që në kuadër të penalistëve, apo atyre që bëjnë vepër penale, kemi një përqindje që edhe këtë e përcjellë, në masë më të madhe, tranzicioni, por edhe në shtetet që kanë traditë kemi grupe që veprojnë kundërligjshëm me paramendim, me qëllim të caktuar, për përfitim të caktuar, por nuk mund t'i viktimizojmë mbi 90% të të burgosurve, të cilët janë duke vuajtur dënimin me një 5%-sh, të cilët me qëllim shkaktajnë vepra të kundërligjshme.

Ata që me qëllim i shkaktajnë veprat e kundërligjshme, po flas gjithherë sepse jam juriste dhe i përcjell pak a shumë këto zhvillime edhe në rajon, edhe pas lirimit prapë do të vazhdojnë me atë avaz. Kur ne si shoqëri nuk po arrijmë të organizohemi, që në start t'ua këpusim rrënjët të gjithë atyre që veprojnë në mënyrë të kontrolluar, në mënyrë të organizuar për të shkaktuar veprim të kundërligjshëm, me qëllim përfitimi individual apo grupor, nuk mund t'i dënojmë edhe një herë, duke mos ua krijuar asnjë dobi atyre që vuajnë dënimin dhe në gjendje afekti kanë shkaktuar vepër penale.

Gjendje afektive për një krahasim formal analogjie, është ta zëmë, një nënë shtatzënë, një nënë lehonë në periudhën e paslindjes, është më e ndjeshmja se çdo rast tjetër, që mund të shkaktojë vepër penale dhe aty ka lehtësira gjatë dënimit dhe gjatë gjykimit...

Andaj, edhe për të dënuarit që nuk janë nga kjo kategori duhet të mendohet që t'i risocializojmë.

Unë mendoj se kjo çështje do shqyrtim logjik, të arsyeshëm, jo për të ndihmuar grupe të qëllimshme, por për të ndihmuar persona të cilët, në gjendje afektive kanë mund të shkaktojnë vepër penale dhe sot janë duke vuajtur dënimin, apo kjo mund të ndodhë edhe në të ardhmen.

Duke e thënë këtë, kam parasysh edhe faktin që ne, si institucione, qoftë gjyqësia dhe në veçanti prokuroria, Policia, mekanizmat sociologjikë që veprojnë apo organizatat që veprojnë në mënyrë të organizuar në shoqërinë – në shtetin e Kosovës, duhet të jenë më tepër prezentë në mënyrë që të punojmë më tepër me qytetarët sepse tash jemi duke i parë pasojat. Pra, menjëherë pas çlirimit në Kosovë jo vetëm se erdhi liria por nuk ishim si popull të përgatitur për transformimin rrënjësor që po bëhet në Kosovë.

Në këtë transformim rrënjësor, që ne kemi dashur të çlirohemi, kemi pasur aleatë që na kanë ndihmuar shumë seriozisht, pas luftës s'i kemi pasur të gjithë mekanizmat që na kanë ndihmuar seriozisht në këtë çështje, qoftë nga organizimi në organizata joqeveritare, qoftë nga mekanizmat e instaluar në Kosovë për të rimëkëmbur Kosovën, për të ndërtuar institucione të Kosovës, për të bërë ligje të Kosovës, për të hartuar strategjitë dhe për t'i implementuar ato.

Andaj, populli i vuan pasojat. Mbi 60% të qytetarëve të Kosovës nuk e dinë se ne jemi duke kaluar në një transformim, jo tranzicion por në një transformim të plotë, edhe mendor, edhe organizativ, edhe profesional, edhe familjar. Dhe, kjo ne na ka shpëtuar, s'kemi ditur as vet.

Andaj, mendoj se kemi mjaft elemente për t'u ndihmuar qytetarëve. Dhe, unë pres komente nga të gjithë mekanizmat në favor të këtij propozimi që të dënuarit mos të na dalin shumëherë më të pavlefshëm se sa në momentin kur e kanë kryer veprën e kundërligjshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit shumë Selvije! Besoj se do të na ndihmojnë edhe këto komente, e unë vetëm po e përsëris, pa dashur të hyj në debat.

E para, ajo që është, jemi të hendikepuar proceduralisht që t'i përfshijmë pjesë të ligjit, shumicën nga këto që u diskutuan, dhe këtë e dinë kolegët e mi deputetë, sidomos pjesa që janë anëtarë të Komisionit të ligjeve. Kjo është e para.

E dyta. Krejt këto që u theksuan, ne i kemi dhënë si rekomandime nga monitorimi i Ligjit, dhe unë po i lexoj disa, sepse sigurisht që duhet të jetë bazë e asaj strategjie, dhe ne kemi theksuar nevojën e nxjerrjes së Ligjit për amnisti, kemi theksuar

mosfunksionimin e institucionit të faljes, mungesën e programeve të risocializimit, ose mostrajtimi i kërkesave për zbatimin e ligjit më të favorshëm për personat e dënuar sipas Kodit të vjetër penal, nevoja për rishikimin e memorandumit lidhur me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë, tash që është kjo pjesa e organizuar, mungesa e udhëzimeve administrative që kanë të bëjnë me beneficionet dhe ka edhe disa çështje që kanë të bëjnë edhe me kodin për të mitur, edhe me rendin shtëpiak dhe shumë gjëra tjera.

Rekomandimet kanë qenë shumë të qarta. Do të thotë, të merret nisma për nxjerrjen e ligjit për amnisti, të rishikohen dispozitat e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale që kanë të bëjnë me përbërjen e panelit për lirim me kusht, të drejtën e shfrytëzimit të pushimit vjetor jashtë institucioneve korrektuese, nxjerrja e udhëzimeve administrative në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale e që kanë të bëjnë me rendin shtëpiak dhe beneficionet, sigurimi i objekteve të ndara për të paraburgosur, në trajtim serioz, dhe tash nuk po du të ju lodhi shumë.

Unë nuk di tash kohë sa do të ketë Ministria e Drejtësisë, por për krejt këto që u biseduan, janë të ndërlidhura edhe me një mori ligjesh, dhe tash pavarësisht objekti, nuk po hy në detale, as për atë që mendojmë ne si deputetë se mund të kemi edhe mendime të ndara dhe përvoja të ndryshme.

Pa u bë harmonizimi me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, do të thotë Ligjin për amnisti, Ligjin për falje, ne nuk mund të ndërhyjmë tash në tërë këtë sferë të ligjeve apo edhe në sferën e përgjithshme që u potencua qoftë edhe me këtë ndryshim, sepse edhe nëse ne do të mund të bëjmë në këtë fazë ndryshimin, duhet të dimë kur fillon, si fillon, si përshtatet me pjesën që janë të dënuar, çka do të quhet pjesa retroaktive, kush do të përfitojë dhe nuk është bash e thjeshtë vetëm kështu si po bisedojmë.

Sido që të jetë, ne nesër do ta trajtojmë, do të shohim, dhe nga sot deri nesër nuk e di sa ka kohë mundësinë edhe Ministria e Drejtësisë si sponzorizues për të na e dhënë një objektiv më të qartë të veten, sepse këta kanë informacione më shumë edhe rreth ndryshim-plotësim ligjeve tjera, por ajo që na duhet ne, ne duhet ta trajtojmë seriozisht edhe Ligjin për Amnisti, pra edhe pjesën që ka të bëjë me faljen, por sidomos pjesën e programeve të risocializimit.

Unë nuk do të hyj të kualifikoj arsyeshmërinë as të veprave, as të beneficioneve, por mungesa e risocializimit duhet të jetë qartë një strategji ekzakte, duke marrë parasysh edhe këto që u thanë, qofshin avancimet, qofshin shembujt e keq, sepse

në fund të fundit ligji duhet të vlejë për të gjithë, duhet të jetë i barabartë për ata që i nënshtrohen, dhe i nënshtrohem i edhe ne, sepse unë ligjin e shoh si masë preventive parandaluese, sepse kur të kryhen aktet janë pjesë të sanksioneve dhe ne i kemi definuar këto shumë qartë me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

Kjo ishte sa për sot. Ne do të shihemi nesër dhe këto që i theksuam, do të shohim se a mund t'i bëjmë pjesë të këtij plotësim-ndryshimi.

Edhe një herë, për hir të korrektësisë, po them proceduralisht, jemi të hendikepuar për shumicën, po edhe atë që e dha zotëriu nga OJQ që ishte për mbrojtjen e viktimave, sepse edhe në të kaluarën kemi pasur bashkëpunim serioz, kështu që shihemi nesër, po do të shihemi edhe në seancën plenare. Faleminderit!

(sipas incizimit, kështu përfundon)